

VENDIM
Nr. 143, datë 24.10.2012

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË KESH SHA PËR ALOKIMIN E KAPACITETEVE TË
INTERKONJEKSIONIT PËR MUAJIN NËNTOR 2012**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “ç”, paragrafi “ii”, dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 7 germa “b” të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe kapitullit X, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike të miratuara nga ERE me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 24.10.2012, pasi shqyrtoi kërkesat e shoqërisë KESH sh.a. nr. 4521 prot. datë 9.9.2012 , nr. 4521/1 prot. datë 10.10.2012 dhe 4541/1, datë 12.10.2012, si dhe relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstaton se:

- Nivelet e rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin, si dhe basenet e tjera të heceve që operojnë në vendin tonë janë të ulëta. Në bazë të informacioneve të marra nga KESH sh.a., niveli i liqenit të Fierzës, në datën 10.10.2012 rezultonte 254 metra, ndërsa rezerva energjitike është 182 GWh.

- Niveli i liqenit të Fierzës në bazë të informacioneve të fundit vijon të bjerë me mbi 80 cm në ditë.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 633, datë 3.10.2012, lejon KESH sh.a., që të bëjë importet e energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve tariforë dhe mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes.

- Në rekomandimin e datës 19.7.2012, Sekretariati i Vjenës, me qëllim që të sigurohet furnizimi pa ndërprerje i konsumatorëve tariforë ka konsideruar të mundshme alokimin e kapaciteteve subjektit mbartës të detyrimit për sigurimin e energjisë elektrike për konsumator tariforë, jashtë ankandeve vjetore/mujore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. OST sh.a. t’i alokojë me të drejta të siguruara pa pagesë shoqërisë KESH sh.a. kapacitetet e lira ndërkufitare të interkonjeksionit për muajin nëntor 2012, për kryerjen e importit të energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve tariforë.

2. OST sh.a. t’i alokojë me të drejta të siguruara pa pagesë furnizuesve të kualifikuar, kapacitetet e lira ndërkufitare të interkonjeksionit për muajin nëntor 2012, proporcionalisht me kontratat që kanë për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve të kualifikuar.

3. OST sh.a. të depozitojë në ERE kontratat e furnizimit të energjisë elektrike ndërmjet furnizuesve të kualifikuar dhe klientët e kualifikuar.

4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a., OST sh.a. dhe “CEZ Shpërndarje” sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani